



Planuar / Dorezuar Primjenal/Prodato Received/Delivery	01.06.2023	viti god year	3
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KPMSSHCK	4569/2023		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.613/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.613/2023 të datës 04.04.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër organit të punësimit/Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike "kontestim konkursi, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 01.06.2023, mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.613/2023 e datës 04.04.2023, e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi me datën 04.04.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesën me numër protokollit 3285/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me procedurën e shpalljes së konkursit nga Komuna e Prizrenit, për pozitën Zyrtar i personelit 2 me datën 15.06.2021 sipas numrit të referencës RN00007124 si dhe për procedurën e shpalljes së konkursit nga po i njëjti institucion për pozitën Zyrtar i personelit 2 me datën 06.10.2022 sipas numrit të referencës RN00010103 shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit ndaj kërkesave të vazhdueshme të ankuesit, me pretendimet ankimore për shkak të : aplikimit të gabuar të së drejtës materiale-ligjit për zyrtarët publikë dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 06.04.2023 ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Prizrenit, ndërsa kjo e fundit me datën 11.05.2023 dhe 17.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me këtë çështje.

Me datën 16.05.2023 për shkak të kompleksitetit të lëndës, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 3285/2023 të datës 04.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 02.11.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore lidhur me listën e ngushtë; Njoftimin e datës 20.05.2022 lidhur me përpilimin e listës së ngushtë; Njoftimin e datës 17.06.2022 lidhur me përfundimin e vlerësimit dhe shpalljen rezultateve me fitues; Njoftimin e datës 27.05.2022 lidhur me përpilimin e listës së ngushtë; Konkursin e datës 06.10.2022 me numër të reference RN00010103; Konkursin e datës 15.04.2022 me numër të referencës RN00008819; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.04.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 11.05.2023 dhe 17.05.2023 nga Komuna e Prizrenit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin e datës 15.06.2021 me numër të referencës RN00007124; Vlerësimin për konkursin me numër të referencës RN00007124 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Listën e aplikantëve tek SIMBNJ; Dokumentet e ankuesit të bashkangjitura tek dosja e konkurimit paraprak lidhur me procedurën në fjalë sipas të cilave dëshmohet përvoja profesionale dhe ajo e punës, certifikatat e trajnimeve, pasqyrën e llogarisë së trustit, autorizimin me Nr.01/030-15605 të datës 05.02.2020, kopjen e letërnjoftimit, formularët e vlerësimit për vitin 2020 dhe 2021 dhe vërtetimin me Nr.02-580-73840/01 të datës 18.06.2021 lidhur me gjendjen për masë disiplinore; Njoftimin e datës 02.11.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore lidhur me përpilimin e listës së ngushtë; Njoftimin e datës 22.11.2022 lidhur me rezultatet e vlerësimit nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Rezultatet përfundimtare të vlerësimit të datës 29.11.2022 lidhur me kandidatin e suksesshëm; Akt emërimit me numër AE.Nr.01-112-167373 të datës 29.11.2022 për F.B; Dokumentet e kandidatit A.S sipas të cilave dëshmohet përvoja profesionale dhe ajo e punës si dhe certifikatat e trajnimeve si dhe dosjen e kandidatit të përzgjedhur F.B së bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale dhe atë të punës, certifikatat e trajnimeve kopjen e letërnjoftimit, formularët e vlerësimit për vitin 2020 dhe 2021 së bashku me dëshminë lidhur me masën disiplinore dhe Vendimin VK/2023 të datës 16.05.2023 nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me vazhdimin e aftit të ankesës së ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa lejuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Komunën e Prizrenit sipas Akt emërimit të datës 29.07.2016 në pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile* në kuadër të Drejtorisë për Administratë. I njëjti kishte aplikuar në konkursin e shpallur të datës 15.06.2021 nga Komuna e Prizrenit lëvizje brenda kategorisë me numër të referencës RN00007124 në pozitën *Zyrtar i Personelit 2*. Komuna e Prizrenit me datë 11.05.2023 përmes përgjigjes në ankesën e ankuesi ka njoftuar Këshillin lidhur me procedurën në fjalë respektivisht ka njoftuar se kjo procedure nuk

kishte përfunduar duke arsyetuar **citoj**: ".....ju njoftojmë se për konkursin me RN00007124 të datës 15.06.2021 për lëvizje paralele për pozitën "Zyrtar i personelit", ish kryetari i komunës Prizren nuk e ka themeluar komisionin përzgjedhës, andaj edhe menaxheri i NJBNJ nuk e ka vazhduar procedurën e rekrutimit".

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...". Ndërlidhur me këtë, neni 13 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar se: "Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë njetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë që i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës me apo një interes juridik, ndërsa neni 125 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton se: "1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: heshtja administrative)" pastaj me dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 i po këtij ligji ka përcaktuar se: "Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ". Përkatesisht sipas këtyre dispozitave ligjore rezulton se çdo nëpunës civil i cili pretendon një veprim administrativ (akt administrativ) apo mos veprim (heshtjes administrative) të organit gjegjes të punësimit, ka të drejtë të parashtror ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës së ankuesit, Kolegji i Këshillit pasi ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të dërguara nga ana e organit të punësimit dhe ankuesi, nuk ka gjetur dëshmi se ankuesi ka parashtruar ankesë deri më tani tek Komuna e Prizrenit apo në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me procedurën e rekrutimit në fjalë edhe pse e njëjta nuk kishte përfunduar gjegjësisht për shkeljen apo cenimin e ndonjë të drejte nga marrëdhënia e tij e punës. Kështu që në vlerësim të Kolegjit ankesa e ankuesit e datës 04.04.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas numrit të protokollit 3285/2023 është e parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ", si dhe nenit 127 paragrafit 4 me të cilin parashihet se: .... 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimimit brenda afateve ligjore sipas dispozitave të lartpërmendura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Prandaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankuesit Nasuf Gërmizaj është e pa lejuar.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me anulimin e procedurës së rekrutimit e shpallur nga Komuna e Prizrenit për pozitën Zyrtar i personelit 2-Lëvizje brenda kategorisë me datën 06.10.20022 sipas numrit të referencës RN00010103, lidhur me sqarimin se kush konsiderohet



palë në procedurën administrative, Kolegji i'u referua nenit 14 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative". Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtar i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë", kështu që, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se nga provat e lëndës nuk ka gjetur dëshmi se ankuesi ka qenë kandidat pjesëmarrës në procedurën e rekrutimit në fjalë apo se nga kjo procedurë i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i tij, gjegjësisht i njëjti nuk e ka legjitimitetin e palës për të parashtruar ankesë lidhur me këtë procedurë të rekrutimit, andaj si rrjedhojë dhe bazuar në këtë konstatim si dhe duke iu referuar nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e ankuesit në këtë drejtim konsiderohet se është pa pranueshme.

Pas konstatimeve si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.613/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Procësbajtëse

Malsore Gashi-Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së